



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ / ____ /2018

V E N D I M

Nr. 16 , Datë 11 / 1 / 2018

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10021, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën Nr. 99, datë 03.08.2017, e bërë nga A.S në emër të bashkëshortit të saj D.K¹, kundër Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, (DRSHSSH) Berat, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “racës” dhe “gjendjes shëndetësore”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës së paraqitur nga A.S, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

Sipas shpjegimeve të dhëna, në formularin e ankesës, subjekti ankues informon se: “*Bashkëshorti i saj është shumë i sëmurë nga një nishan. Ankuesja dhe bashkëshorti janë të papunë dhe kanë një fëmijë 3 vjeç. A.S kërkon që bashkëshorti i saj të përfitojë pagesën e KMCAP*”.

Diskriminimi për shkak të racës dhe gjendjes shëndetësore janë disa nga shkaqet për të cilin ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ofron mbrojtje dhe bazuar në nenin 32/1/c të këtij ligji, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet, që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me racën dhe gjendjen shëndetësore.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: “*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër*”.

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10221/2010, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën

¹ Ankesa është administruar në kuadër të aktivitetit “Ditë të hapura” me komunitetin rom, organizuar nga KMD.

dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën Nr. 796/1, datë 28.09.2017, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka njoftuar dhe ka kërkuar informacion nga ana e DRSSH Berat, lidhur me ankesën e bërë nga A.S.

Me shkresën Nr. 3328/1, datë 07.09.2017 të dërguar pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Berat informon se: *“Nga verifikimi i regjistrave të kërkesave në DRSSH Berat rezulton se shtetasi D.K nuk ka paraqitur kërkesë për të përfitur nga KMCAP Berat. Në bazë të ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në RSH” i ndryshuar si dhe rregullores “Për caktimin, administrimin dhe pagesën e pensioneve” çdo person që pretendon të përfitojë nga sistemi i sigurimeve shoqërore duhet të paraqesë kërkesë, bashkë me dokumentacionin e kërkuar në DRSSH ku banon”.*

- Me shkresën Nr. 796/3, datë 21.09.2017, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka njoftuar dhe ka kërkuar informacion nga ana e DRSHSSH Berat, lidhur me ankesën e bërë nga A.S.

Me shkresën Nr. 421/1, datë 29.09.2017 të dërguar pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të administruar tek Komisioneri me nr. 796/4 prot, datë 11.10.2017, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, Berat informon se: *“Pranë DRSHSSH Berat nuk është paraqitur asnjë kërkesë me shkrim nga A.S. A.S përfiton pagesë nga aftësia e kufizuar në masën 10140 lek në muaj, ndërsa bashkëshorti i saj së bashku me fëmijën përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike 3300 lek në muaj. Për sa i përket pagesës së aftësisë së kufizuar, D.K duhet ti drejtohet mjekut specialist i cili vendos në bazë të gjendjes shëndetësore nëse i takon ose jo fletëdrejtimi për KMCAP”.*

Në vijim të procedurave hetimore, mbështetur në Urdhrin nr.135, datë 06.10.2017 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi “Për kryerjen e inspektimit në DRSHSSH Berat”, inspektorët e KMD-së u paraqitën pranë DRSHSSH Berat, më datë 11.10.2017, për të marrë informacionin e kërkuar me shkresën nr.804/1, datë 08.09.2017.

Gjatë inspektimit,B me detyrë Drejtore e DRSHSSH Berat, dorëzoi një kopje të shkresës përgjigje nr. 421/1, datë 29.09.2017, drejtuar Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Në përfundim të procedurave të shqyrtimit të ankesës dhe bazuar në dokumentacionin e administruar, Komisioneri vëren se:

Ligji nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” (i ndryshuar) dhe aktet nënligjore në zbatim të tij rregullojnë llojet dhe kushtet e përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara në skemën e aftësisë së kufizuar, për shkaqe që nuk lidhen me punësimin. Në Kreun II “Përfituesit e ndihmës dhe të shërbimit shoqëror” neni 7, pika 3 të këtij ligji, përcaktohet se: *“Përfitues të pagesës për aftësinë e kufizuar janë: Personat me aftësi të kufizuar, të cilët deklarohen të paaftë për punë me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë”*.

Referuar Kreut I, pika 1 të VKM nr. 618, datë 07.09.2006 “Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar”, *“Personat, të cilëve u është kufizuar aftësia, si pasojë e dëmtimeve fizike, shqisore, të intelektit, psikike/mendore, të lindura apo të fituara gjatë jetës nga aksidente, sëmundje, të përkohshme apo të përhershme, që nuk vijnë nga shkaqe, që lidhen me punësimin, e vërtetuar kjo nga Komisioni Mjekësor i Aftësisë për Punë (KMCAP), përfitojnë pagesë për shkak të aftësisë së kufizuar”*. Në pikën 4 të këtij Kreu përcaktohet se: *“Vlerësimi i gjendjes mjekësore të personave me aftësi të kufizuar, të përcaktuar në pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi, bëhet nga KMCAP, i cili është i ngritur dhe funksionon pranë ISSH, ku merr pjesë, si anëtar me të drejtë vote, edhe mjeku, punonjës i SHSSH”*. Gjithashtu në Kreun III “Procedurat dhe dokumentacioni për përfitimin e pagesës për aftësi të kufizuar”, pika 19/ç të këtij vendimi, përcaktohet se: *“Personat, që kërkojnë të komisionohen për vlerësimin e aftësisë së kufizuar, duhet të paraqesin në seksionet e ndihmës dhe të përkujdesjes shoqërore të bashkisë, dokumentacionin e mëposhtëm: a) ç) Fletëdrejtimin për në KMCAP, kur personi komisionohet për herë të parë”*.

Rregullorja datë 30.05.2005 “Për organizimin, të drejtat, detyrat dhe funksionimin e komisionit mjekësor të caktimit të aftësisë për punë të invalidëve” përcakton procedurën për komisionimin e personave me aftësi të kufizuar për drejtimin për herë të parë në KMCAP. Drejtimi i personave me aftësi të kufizuar për herë të parë në KMCAP bëhet nga institucionet mjekësore me shtretër dhe nga Komisionet Mjekësore (KM), kur i sëmuri paraqitet për herë të parë në KMCAP. “Fletë Drejtimi për në KMCAP” është dokumenti kryesor mjekësor që pasqyron gjendjen shëndetësore të të siguarit me qëllim komisionimin e tij nga KMCAP, për efekt përfitimi sipas ligjit “Për ndihmë dhe shërbime shoqërore”. Në këtë mënyrë ky dokument plotësohet me korrektësi dhe përgjegjësi, nga Mjeku kurues apo nga Komisionet Mjekësore duke iu përgjigjur plotësisht të gjitha rubrikave të formatit. Pajisja ose jo e kërkuesit me këtë dokument vendoset në vizitën e përgjithshme nga shefi i klinikës ose shefi i shërbimit. Kur kërkuesi vuan nga sëmundje kirurgjikale, ortopedike dhe gjendjeje pas djegieve dhe paraqitet për herë të parë në KMCAP, diagnoza të cilat nuk përbëjnë objekt trajtimi në institucionet me shtretër, drejtohet në KMCAP nga Komisionet Mjekësore (KM) duke plotësuar fletë drejtimin për në KMCAP. Më tej kërkesa për përfitim (pagesën e aftësisë të kufizuar apo pensionin e invaliditetit) së bashku me dokumente plotësuese paraqitet pranë Njësisë Bashkiake të vendbanimit të aplikantit, e cila procedon me hapjen e dosjes dhe verifikimin e dokumentacionit.

Bazuar në përgjigjen shkresore të dërguar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Berat dhe Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, Berat², nuk rezulton të ketë diskriminim nga ana e këtyre institucioneve, pasi jemi në situatën kur subjekti ankues nuk ka aplikuar për të përfituar pagesë për aftësisë e kufizuar, duke plotësuar fillimisht dokumentacionin përkatës të gjendjes së tij shëndetësore.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 32, pika 1/a dhe c/, nenin 33, pika 10 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit për shkak të racës dhe gjendjes shëndetësore, ndaj D.K, nga ana e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Berat dhe Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, Berat.
2. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i rekomandon subjektit ankues, se nëse kërkon të përfitojë pagesë për aftësinë e kufizuar, të paraqitet pranë institucioneve të sipërcituara për të kryer vizitën mjekësore dhe plotësuar dokumentacionin përkatës.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda afateve ligjore.

Irma BARAKU

KOMISIONERI

(shkaku: raca dhe gjendja shendetesore)

(fusha: te mira dhe sherbime)

² Shkresat Nr. 3328/1, datë 07.09.2017 dhe Nr. 421/1, datë 29.09.2017.